

Shkarkohet gjyqtari i Apelit të Shkodrës, Selim Kryeziu

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Kryeziu, pas problemeve me pasurinë dhe pastërtinë e figurës.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Gjyqtari i Apelit të Shkodrës, Selim Kryeziu pas shpalljes së vendimit. Foto: Edmond Hoxhaj.

Gjyqtari i Apelit të Shkodrës, Selim Kryeziu u shkarkua nga detyra mëngjesin e së mërkurës, pas problemeve të evidentuara me pasurinë dhe figurën. Vendimi u shpall nga trupa gjyqësore e kryesuar nga Valbona Sanxhaktari dhe anëtare Etleda Çifta dhe Xhensila Pine.

Selim Kryeziu e ka nisur karrierën në sistemin e drejtësisë në vitin 1998 si gjyqtar dhe më pas kryetar i Gjykatës së Librazhdit. Në vitin 2006, ai është emëruar inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa në vitin 2012 u promovua si gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Shkodrës.

Gjatë seancës dëgjimore, Kryeziu u përball me probleme të pasurisë, përfshi mosjustifikimin e të ardhurave të disa personave të lidhur në shumë 20 mijë euro, të cilat i kishte marrë hua. Ndërsa analiza financiare për disa vite e nxirrte gjyqtarin me bilanc negativ prej rreth 5.6 milionë lekësh.

Relatorja ndërkohë lexoi një raport negativ nga DSIK. Raporti e akuzonte gjyqtarin për tre raste mitmarrje dhe për përfshirje aktive në korrupsion, ndërsa vlerësonte se ai nuk ishte i përshtatshëm për të vijuar detyrën.

Kryeziu që bëri një rezymë të gjatë të punës së tij dhe shkollimit tha se ishte i pastër dhe kishte qenë i paanshëm e i drejtë në punë. Ai pretendoi se të gjithë të afërmit prej të cilëve kishte marrë hua i kishin justifikuar pasuritë.

Kryeziu ndërkohë kundërshtoi analizën financiare dhe i kërkoi KPK të merrte në konsideratë një raport nga kontabilisti i punësuar prej tij. Ai tha se shpezimet e llogaritura nga ILDKPKI ishin më të larta dhe se kishte bërë jetë modeste.

Ai kundërshtoi edhe raportin e DSIK-së dhe akuzoi një çift prokurorësh, se kishin sajuar çdo gjë kundër tij.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.